

Imperial Group Sh.a

**Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2021**

Përbajtja

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE.....	4
1. Informacion i pergjithshem	5
2. Permbledhje e politikave kryesore kontabel	5
3. Politikat kontabel.....	6
4. Mjete monetare	9
5. Llogari te arketueshme tregtare	9
6. Te tjera llogari te arketueshme.....	9
7. Inventari	10
8. Aktive afatgjata materiale dhe jomateriale	11
9. Te tjera te drejta ndaj te treteve	12
10. Hua afatshkurtra dhe afatgjata	12
11. Arkëtime në avance për porosi.....	12
12. Llogari të pagueshme tregtare	12
13. Detyrime tatimore.....	12
14. Provizione	12
15. Te tjera te pagueshme.....	12
16. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit.....	12
17. Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	13
18. Shpenzime te tjera	13
19. Te ardhura te tjera	13
20. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin.....	14
21. Angazhime dhe pasiguri.....	14
22. Ngjarje te mepasshme.....	14
23. Shpenzime te personelit.....	14

IMPERIAL GROUP SH.A

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 dhjetor 2021

	Shënim	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	107,889,340	122,265,724
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	1,340,000	240,000
Të tjera llogari të arketueshme	6	1,138,676	1,108,677
Inventari	7		
Total Aktive Afatshkurtra		110,368,016	123,614,401
Aktivet afatgjata			
Te tjera te drejta ndaj te treteve	8	111,918,581	404,866,359
Aktive afatgjata materiale	8	11,604,350	76,423,055
Aktive afatgjata jomateriale	9	404,866,359	13,652,176
Total aktive afatgjata		528,389,290	494,941,590
Total Aktive		638,757,305	618,555,991
DETYSIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10		
Arkëtime në avance për porosi	11		
Llogari të pagueshme tregtare	12	46,000,000	200,000
Detyrime ndaj punonjesve		-	187,616
Detyrime tatimore e te tjera buxhetore	13	9,339,583	10,097,914
Provizione	14		
Total Detyrime afatshkurtra		55,339,583	10,485,530
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	10		
Te tjera te pagueshme	15		
Total Detyrime afatgjata			
Totali i detyrimeve		55,339,583	10,485,530
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		567,700,000	381,700,000
Rezerva ligjore e te tjera		2,146,792	2,146,792
Fitime te mbartura		29,223,669	228,337,388
Fitimi i Vitiit		(24,652,739)	(4,113,719)
Total kapitali themeltar		583,417,722	608,070,461
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		638,757,305	618,555,991

Këto pasqyra financiare dhe shënimet shoqëruese nga 1 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare, janë aprovuar nga drejtimi dhe nëshkruar në emër të tij me 27 Mars 2021 nga:

Administrator
Gentjan HAKA



Kontabel I Miratuar

Albana LUSHAJ


PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Shenime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	16	1,100,000	200,000
Te ardhura te tjera		1,013,898	18,972,608
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme			
1) Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	17		
2) Te tjera shpenzime	18		
Shpenzime te personelit			
1) Paga dhe shperblime	21	(9,369,847)	(5,041,715)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetore (paraqitur vecmas nga shpenzimet per pension)		(8,272,698)	(4,346,000)
2) vecmas nga shpenzimet per pension	21	(1,097,149)	(695,715)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	21	(12,552,302)	(16,374,299)
Shpenzime te tjera te shfrytezimit	18	(4,825,395)	(1,870,323)
Te ardhura te tjera			
Fitim /humbje nga kurset e kembimit		(158)	35
		(158)	35
Shpenzime financiare			
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet per t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)		(18,936)	(24)
1) shpenzimet per t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit			(24)
2) Shpenzime te tjera financiare		(18,936)	
Fitimi/humbja para tatimit			
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	20		
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
		-	-
Fitimi/humbja e vtit			
		(24,652,739)	(4,113,719)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(24,652,739)	(4,113,719)

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

IMPERIAL GROUP SH.A*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Kapitali themeltar	Rezerva ligjore	Fitim/(Humbja) akumuluar	Fitim/(Humbja) e vitit	Totali
Pozicioni finansiar më 31 dhjetor 2020	381,700,000	2,146,792	228,337,388	(4,113,719)	608,070,461
Pozicioni finansiar më 31 dhjetor 2021	576,700,000	2,146,792	29,223,669	(24,652,739)	583,417,722

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

IMPERIAL GROUP SH.A

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përvèç kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Shenime	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi i vtit		(24,652,739)	(4,113,719)
Shpenzime financiare jomonetare			
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	20		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	12,552,302	16,374,299
Rënje/(rritje) në llogarite e arketueshme	5	(1,100,000)	(240,000)
Rënje/(rritje) në llogarite e tjera te arketueshme	6	(29,999)	(28,362,499)
Rënje/(rritje) në Inventar	7		-
Rënje/(rritje) në te tjera te drejta ndaj te treteve	9		-
Rënje/(rritje) në arkëtime në avance për porosi	11		-
Rritje/(rënje) në llogarite e pagueshme dhe detyrime te tjera	12	45,800,000	200,000
Rritje/(rënje) në detyrimet ndaj punonjeve		(187,618)	187,616
Rritje/(rënje) në detyrimet tatimore e te tjera buxhetore	13	(758,331)	(24,435,620)
Rritje/(rënje) në provizione	14		-
Tatim fitimi i paguar			-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		31,623,615	(40,389,923)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	8	(46,000,000)	-
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	8	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(46,000,000)	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Hua të arkëtuara	10		-
Pagesa te kapitalit themeltar	10		-
Te hyra të qirasë financiare	10		-
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare	10		-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			-
Rritje/(rënje) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		(14,376,385)	(40,389,923)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	4	122,265,725	162,655,647
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	107,889,339	122,265,725

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**IMPERIAL GROUP SH.A
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021**

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përvèç kur shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqeria Imperial Group Sh.a (me poshte referuar si "Shoqeria") eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me date 24 Dhjetor 2010 dhe prane Deges se Tatimeve dhe Taksave Tirane me NIPT L02424005D. Shoqeria zoterohet nga ortaket Pellumb Gjoka ne masen 90% dhe Kole Gjoka ne masen 10%.

Me 31 dhjetor 2021, vlera e kapitalit themeltar eshte 567,700,000 Leke, e ndare ne 2 kuota me vlere nominale 521,682,820 Leke dhe 55,017,180 Leke e ndare sipas % te mesiperme te zoterimit te kapitalit.

Veprimtaria e Shoqerise rregullohet ne perputhje me dispozitat perkatese te Ligjit 9901, date 14 prill 2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", si dhe nga akti i themelimit dhe statuti i saj. Objekti kryesor i aktivitetit te Shoqerise eshte: Kryerja e veprimtarise tregtare ne fushen e lojrave te fatit. Importimi, eksportimi i mallrave. Hoteleri, turizem e sherbime te tjera. Veprimtari ne fushen e ndertimit te objekteve civile-industriale-turistike bujqesore mbi 5 kate. Rikonstruksione e Ndertim banesa me skelet mbi 8 kate. Ndertim rruge, ura dhe vepra arti deri ne 10m; Ndertim ujesjelles-kanalizime; Kanale impiante vaditje-kullimi. Shoqeria mund te marre pjesë ne cilesine e ortakut apo te aksionerit ne shoqeri te tjera tregtare me objekt te njejtë ose te ndryshem. Ne perputhje me legjisacionin shqiptar, ne menyre qe te arrije objektin e lartpermendur, shoqeria mundet gjithashtu: Te kryeje cdo transaksion lidhur me asetat e luajtshme ose pasurite e paluajtshme, vendosja e pengjeve, hipotekes, barreve si dhe aktivitete te cilat mund te konsiderohen te nevojshme per te arritur aktivitetin e shoqerise. Shoqeria mund te kryeje aktivitete te tjera te cilat nuk ndalojen nga ligji ne fuqi, te vlefshme dhe me interes per shoqerine, me ane te pajisjes me licencat e nevojshme.

Administratori i Shoqerise eshte Z.Gentjan Haka.

Selia kryesore e Shoqerise ndodhet ne Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati Mig-Mar, Pallati 12 katesh , Kati 1, Nr.Pasurie 2/144-N2.

Numri i punonjesve ne daten 31.12.2021 eshte 7.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL

2.1 Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te shpallura me date 15 qershor 2006, te permiresuara dhe te detyrueshme per zbatim per pasqyrat financiare qe pregatiten pas 01 janar 2015, ne perputhje me Ligjin 25/2018 date 10.05.2018 "Per Kontabilitietin dhe Pasqyrat Financiare" te ndryshuar.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike me perjashtim te rasteve kur percaktohet ndryshe, nese ka te tilla.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare te ndermjetme jane prezantuar ne Leke, e cila eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise.

2.4 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njoitura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.

**IMPERIAL GROUP SH.A
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021**

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabel te me poshtme jane aplikuar ne menyre konsistente gjate periudhes per te cilen jane pergatitur keto pasqyra financiare te ndermjetme, perveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e bilancit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jomonetare te paraqitura ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlera e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit te perdonura ne konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare me 31 dhjetor 2020 jane:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Leke/Euro	120.39	123.7
Leke/Dollare Amerikan	106.08	100.84

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare joderivative perbehesh nga llogari te arketueshme, mjete monetare dhe llogari te pagueshme dhe qeraja financiare.

Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksi me lidhet me to, perveç siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojne ne shpenzime dhe te ardhura. Ne vijim te njoftes fillestare instrumentat financiar joderivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument finanziar njihet nese Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te Shoqerise mbi flukset e parase se aktivit finanziar ose kur Shoqeria transferon aktivin finanziar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen Shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anullohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase (mjetet monetare) perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellime te pasqyres se fluksit te parase, paraja dhe ekuivalentet te saj perfshijne llogarite rrjedhese dhe parane e gatshme ne arke.

Llogari te arketueshme

Llogarite e arketueshme (kerkesat e arketueshme) njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigioni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se Shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesa qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij finanziar, mospagesa ose pagesa te vonuara konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provigionit llogaritet si diferenca midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdonur metoden e interesit efektiv.

**IMPERIAL GROUP SH.A
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021**

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përvèç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.2 Instrumentat financiare (vazhdim)

Qeraja financiare dhe huate afatgjata

Qeraja financiare dhe huate afatgjata paraqitet me vleren e tyre te drejtë dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Te tjera

Instrumenta te tjere joderivative maten me kosto te amortizuar sipas metodes se interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvleresimi.

3.3 Inventaret

Inventaret percaktohen me vleren me te vogel midis kostos dhe vleres neto te realizueshme. Kostoja percaktohet duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar dhe perfshin shpenzimet e kryera per perfimin e inventarit dhe kosto te tjera te kryera per dergimin e inventareve ne destinacion dhe me kushtet e kerkuara. Vlera neto e realizueshme i referohet vleres neto qe Shoqeria pret te perfitoje nga shitja e inventarit, ne rrjedhen normale te biznesit

3.4 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivit. Ne rastet kur pjese te nje aktivi afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur, dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe Shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke marre per baze jeten e dobishme te aktivit duke filluar nga dita kur ai eshte i gatshem per perdorim.

Metoda e amortizimit,jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne çdo date raportimi. Metodat e amortizimit dhe perqindjet perkatese sipas grupave te aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale per periudhen aktuale jane si me poshtë:

Permiresime ne qiramarrje	5 % mbi vleren kontabel neto
Mjete transporti	20% mbi vleren kontabel neto
Makineri dhe paisje	20% mbi vleren kontabel neto
Paisje informatike	25% mbi vleren kontabel neto
Orendi dhe pajisje zyre	20% mbi vleren kontabel neto
Software	15% mbi vleren kontabel

Cregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerra e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

IMPERIAL GROUP SH.A
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021
(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.5 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale qe kane një jetë te percaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvleresimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes se aktivit te zgjedhur me vleren e tij te mbetur. Shuma e amortizimit kalon ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne menyre zbritese per gjate jetes se aktivit. Shoqeria ka vetem te drejtat e perdonimit te njoftur ne keto pasqyra financiare.

3.6 Zhvleresimi

Aktivet financiare

Nje aktiv finanziar konsiderohet i zhvleresuar nese ka te dhena objektive qe tregojne se nje apo disa ngjarje kane efekte negative ne flukset e ardhshme qe parashikohet te burojne nga aktivi.

Nje zhvleresim ne lidhje me aktivin finanziar, te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si diferenca midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase, te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktivet financiare te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne menyre individuale. Aktivet e tjera financiare vleresohen ne menyre te grupuar, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut kreditor. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me nje aktiv finanziar te disponueshem per shitje i njoftur me pare ne kapital, transferohet ne shpenzime.

Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njoftes se humbjes nga zhvleresimi. Per aktivet financiare te matura me kosto te amortizuar, rimarrja njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivet jofinanciare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare te Shoqerise, rishikohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka te dhena per zhvleresim. Nese ka te dhena te tilla atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera e mbetur e nje aktivi tejkalon vleren e tij te rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

3.7 Provigionet

Nje provigion njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, Shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje flukse dalese parash per shlyerjen e tij. Provigionet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale.

3.8 Njofta e te ardhurave

Te ardhurat jane flukset hyrese bruto te perfitimeve ekonomike lindur ne rrjedhen normale te aktiviteve te Shoqerise qe rezultojne ne rritje te kapitalit neto gjate periudhes dhe nuk perfshijnë rritjet e kapitalit neto ne saje te kontributive te ortakeve. Te ardhurat perfshijnë vleren e drejte te shumes se arketuar apo te arketueshme nga shitja e mallrave dhe sherbimeve ne rrjedhen normale te aktiviteve te Shoqerise. Te ardhurat nuk perfshijnë tatimin e vleres se shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet, nese ka.

Te ardhurat nga sherbimet e ofruara njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne varesi te fazes se perfundimit te transaksionit ne daten e raportimit. Asnje ardhur nuk njihet nese ka pasiguri te larte lidhur me kryerjen e pageses dhe kostove perkatese.

Shoqeria siguron te ardhura nga shitja e produkteve te dezinfektimit dhe sherbimeve dezinfektuese.

**IMPERIAL GROUP SH.A
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021**

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.9 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne fitimet nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve si dhe te ardhura te tjera nga interesat e llogarive rrjedhese apo depozitave. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit per qerane financiare, humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet llogarise fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatushem të vitit, duke aplikuar normat tatile me fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (31 dhjetor 2020: 15%).

4. MJETE MONETARE

Mjetet monetare përfaqësojnë llogaritë rrjedhëse qe Shoqëria ka me bankat në Shqipëri si dhe paraja ne arke ne valute dhe ne monedhe vendase. Më poshtë po ju japim një detajim të llogarive me 31 dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Para ne bankë		
Leke	44,137	26,705
Euro	38,499	17,219
USD	5,638	9,487
Para ne arkë		
Leke	107,845,202	122,239,019
Euro	107,845,202	122,239,019
USD		
Totali	107,889,340	122,265,724

5. LLOGARI TE ARKETUESHME TREGTARE

Llogarite e arketueshme perbehen nga vlerat e te drejtave ndaj klienteve te Shoqerise te cilat nuk kane shlyer ende detyrimin deri ne daten e ndertimit te pasqyrave financiare. Me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020

detajimet persa i perket klienteve me te medhenj paraqiten si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Frozzer shpk	1,340,000	240,000
Total	1,340,000	240,000

6. TE TJERA LLOGARI TE ARKETUESHME

Te tjera llogari te arketueshme perfshijne vlerat e paguara ne dogane ne fund te periudhes te cilat mbyllen ne fillim te vitit pasardhes si dhe te tjera te drejta ndaj te treteve. Balancat e tyre me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Debitore te tjere(Dogana)		
Tatim Fitimi	10,000	
TVSH e arketueshme	1,128,677	1,108,677
Total	1,138,677	1,108,677

**IMPERIAL GROUP SH.A
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021**

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. INVENTARI

Inventari me 31 dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020 perbehet si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Mallra per rishitje	-	-
Te tjera	-	-
Totali	-	-
Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve dhe aksionereve	130,000,000	130,000,000
Imperial Construction	243,100,200	243,100,200
Frozzer shpk	31,766,159	31,766,159
Totali	404,866,359	404,866,359

**IMPERIAL GROUP SHA
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021**

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përvç kur shprehet ndryshe)

3. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE

Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 perfaqesojnë sa me poshtë:

	Toke djerre	Ndertesa	Makineri & paisje punë	Mjetë transport	Paisje zyre dhe informatike	Totali AAM	AAJM	Totali AAM dhe AAJM
<i>Kosto</i>	në Lekë	në Lekë	në Lekë	në Lekë	në Lekë	në Lekë	në Lekë	në Lekë
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	17,700,000	28,000,000	24,465,308	6,737,611	102,037,156	178,940,075	18,202,901	197,142,976
Shtesa	-	-	-	-	-	-	-	-
Pakësimë	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	17,700,000	28,000,000	24,465,308	6,737,611	102,037,156	178,940,075	18,202,901	197,142,976
<i>Gjendja më 31 Dhjetor 2021</i>	<i>63,700,000</i>	<i>28,000,000</i>	<i>24,465,308</i>	<i>6,737,611</i>	<i>102,037,156</i>	<i>224,940,075</i>	<i>18,202,901</i>	<i>243,142,976</i>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>								
<i>Gjendja më 31 Dhjetor 2019</i>		<i>(7,417,427)</i>	<i>(20,899,327)</i>	<i>(3,663,607)</i>	<i>(56,892,795)</i>	<i>(88,873,156)</i>	<i>(1,820,290)</i>	<i>(90,693,446)</i>
<i>Shpenzimi i periudhës</i>								
<i>Gjendja me 31 Dhjetor 2020</i>		<i>(1,029,129)</i>	<i>(713,196)</i>	<i>(614,801)</i>	<i>(11,286,738)</i>	<i>(13,643,864)</i>	<i>(2,730,435)</i>	<i>(16,374,299)</i>
<i>Gjendja me 31 Dhjetor 2021</i>		<i>(8,446,556)</i>	<i>(21,612,523)</i>	<i>(4,278,408)</i>	<i>(68,179,533)</i>	<i>(102,517,020)</i>	<i>(4,550,725)</i>	<i>(107,067,745)</i>
<i>Vlera Nëto Kontabel</i>								
<i>Gjendja më 31 Dhjetor 2019</i>	<i>17,700,000</i>	<i>20,582,573</i>	<i>3,565,981</i>	<i>3,074,004</i>	<i>45,144,361</i>	<i>90,066,919</i>	<i>16,382,611</i>	<i>106,449,530</i>
<i>Gjendja më 31 Dhjetor 2020</i>	<i>17,700,000</i>	<i>19,553,444</i>	<i>2,852,785</i>	<i>2,459,203</i>	<i>33,857,623</i>	<i>76,423,055</i>	<i>13,652,176</i>	<i>90,075,231</i>
<i>Gjendja më 31 Dhjetor 2021</i>	<i>63,700,000</i>	<i>18,575,772</i>	<i>2,282,228</i>	<i>1,967,362</i>	<i>25,393,217</i>	<i>111,918,580</i>	<i>11,604,349</i>	<i>123,522,929</i>

**IMPERIAL GROUP SH.A
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021**

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përvet kur shprehet ndryshe)

9. TE TJERA TE DREJTA NDAJ TE TRETEVE

Te tjera te drejta ndaj te treteve perbehet nga vlera nga pale te treta qe ne daten e ndertimit te bilancit nuk kane shlyer detyrimin perkates ndaj Shoqerise dhe kane afat te gjate te pageses se detyrimit. Me 31 dhjetor 2021 shoqeria nuk ka te tilla detyrime.

10. HUA AFATSHKURTRA DHE AFATGJATA

Llogaria hua afatshkurtra perfshin hua te dhena nga palet e lidhura (ortake dhe kompani ku ortaku ka aksione). Keto jane hua te dhena per fillimin e biznesit dhe do te shlyhen brenda vitit qe vjen.

Kjo llogari me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 perbehet si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Pjesa afatshkurger:		
ORTAKU	-	-
Totali huase afatgjate	-	-

11. ARKËTIME NË AVANCE PËR POROSI

Arketime ne avance per porosi nuk ka ne 31.12.2021

12. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Te pagueshme ndaj furnitoreve perbehet nga vlera per tu paguar per sherbimet, mallrat, etj. por te papaguara ende ne fund te periudhes. Nje detajim me i hollesishem i llogarive te pagueshme me kryesore jepet ne shenimin me poshte.

Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Ylli Manjani		200,000
Turboo Albania	46,000,000	
Totali	46,000,000	200,000

13. DETYRIME TATIMORE

Llogaria e detyrimeve tatimore me 31 dhjetor 2021 perbehen si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
TVSH e pagueshme		
Detyrim tatim fitimi		795,822
Te tjera	18,559	26,001
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	227,099	182,166
Detyrim ndaj Autoritetit te Mbikeqyrjes se lojrave te fatit	9,093,925	9,093,925
Totali	9,339,583	10,097,914

14. PROVIZIONE

Provizonet nuk ka pasur ne 31.12.2021

15. TE TJERA TE PAGUESHME

Te tjera te pagueshme nuk ka pasur ne 31.12.2021

16. TE ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTEZIMIT

Shoqeria siguron te ardhura kryesishet nga mjete me qera. Nje detajim i te ardhures neto te Shoqerise jepet si me poshte:

**IMPERIAL GROUP SH.A
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021**

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Te ardhura nga mjete me qera	1,100,000	18,972,608
Te tjera	1,013,898	200,000
Totali	2,113,898	19,172,608

17. LENDA E PARE DHE MATERIALE TE KONSUMUESHME

Lenda e pare dhe te tjera materiale te konsumueshme per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020

Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Qera	-	-
Shpenzime te tjera lidhur me operacionet	-	-
Totali	-	-

18. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzime te tjera per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 perbehen si me poshte

Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Blerje te pastokueshme	-	-
Sherbim kontabiliteti	647,400	420,000
Sherbime ligjore		174,584
Sherbim Pastrim Kimik		57,092
Energji	59,634	
Sigurime	41,000	43,740
Qera	1,710,596	170,451
Sherbim Konsulence	1,233,462	
Taksa dhe Tarifa Vendore	271,542	
Shpenzime posare dhe telekomunikacioni	663,018	853,615
Sherbime bankare	18,936	15,432
Gjoba dhe demshperblime	180,142	99,929
Te tjera	18,600	35,480
Totali	4,844,330	1,870,323

19. TE ARDHURA TE TJERA

Te ardhura te tjera përfshijnë fitimet nga kurset e kembimit si me poshte per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021

Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Humbje nga kurset e kembimit te parealizuara	158	24
Totali	158	24

IMPERIAL GROUP SH.A
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021
(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

20. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Ne perputhje me ligjet tatimore shqiptare, norma e aplikueshme per tatimin mbi fitimin per periudhen 2021 eshte 15% (31 dhjetor 2021: 15%). Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit, por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara per qellime tatimi jane vetedeklarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare jane objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Shoqeria per vitin 2021 rezulton me humbje si per qellime kontabile ashtu dhe per qellime fiskale. Nje rikonsilim i tatim fitimit paraqitet si me poshte:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Fitimi para tatimit	(24,652,739)	(4,113,719)
Rregullime per:		
Shpenzime te tjera te pazbritshme	180,142	99,929
Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)	(24,472,597)	(4,013,790)
Tatim fitimi @15%		
Fitimi Neto	(24,652,739)	(4,113,719)

21. SHPENZIME TE PERSONELIT

Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Paga dhe shperblime	8,272,698	4,346,000
Shpenzime te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore(paraqitur vecmas nga shpenzimet per pension)	1,097,149	695,715
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	12,552,302	16,374,299
Totali	21,922,149	21,416,014

22. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treta. Me 31 dhjetor 2021, Shoqeria nuk ka çeshtje te cilat do te kene efekte negative ne pozicionin finanziar te Shoqeria ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Gjithashtu, me 31 dhjetor 2021, Shoqeria nuk ka angazhime kapitale te kontraktuara por ende te papaguara.

23. NGJARJE TE MEPASSHME

Nuk ka asnjë ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.